



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:171028
Datë: 02.04.2024
Numri i dokumentit: 05532870

Ac.nr.6280/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Liridon Maloku, kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Naim Mehulli, anëtar, në çështjen juridike kontestimore të paditësve D.K dhe D.K-K, të cilat i përfaqëson me autorizim avokati B.M, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “E”, të cilën e përfaqëson me autorizim V.A, për kompensimin e dëmit jo material dhe material, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë C.nr.933/19 e datës 29.06.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 25/03/2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa themeltë ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “E” dhe VËRTETOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë C.nr.933/19 e datës 29.06.2021.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin ankimor C.nr.933/19 e datës 29.06.2021, ka vendosur si vijon:

I. APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR, kërkesëpadia e paditëses D.K, ashtu që DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “E” me seli në Prishtinë, që paditëses në emër të shpërblimi të dëmit si pasoj e aksidentit të datës 31.05.2019, ti paguaj shumat e specifikuara si më poshtë:

Dëmi jo material:

- për dhimbjet e përjetuara fizike1.500 euro,
- për shkak të frikës së përjetuar800 euro,

Dëmi material

- për shpenzimet për kujdes dhe ndihme te huaj.....100 euro,
- për shpenzime për ushqimin e përforcuar.....70 euro,

II. REFUZOHET PJESËRISHT SI E PABAZUAR, kërkesëpadia e paditëses D.K, përtej shumës së gjykuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi për shumat e specifikuara si më poshtë:

Dëmi jo material

- për dhimbjet e përjetuara fizike1.000 euro,
- për shkak të frikës së përjetuar1.000 euro,

Dëmi material

- për shpenzime të mjekimit.....100 euro,
- për shpenzime të terapisë fizikale.....400 euro.

III. APROVOHET NË TËRËSI SI E BAZUAR, kërkesëpadia e paditëses D.K-K , ashtu që DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “E”, që paditëses në emër të shpërblimi të dëmit material në veturën e markës Toyota me targa 03-340-FE si pasojë e aksidentit të datës 31.05.2019, tja paguaj shumat prej 975 euro.

IV. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “E” që shumat e gjykuara si në pikën I dhe III të dispozitivit të këtij aktgjykimi t’ua paguaj paditësve me kamatë vjetore prej 8% në vit, të cilat do të përlllogariten duke filluar nga data 31.05.2021 e deri në pagesën definitive, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarimit.

V. DETYROHET e paditura KS. “E” që paditëseve D.K, D.K-K solidarisht t’ua paguaj edhe shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 1.057.40 euro.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur i autorizuari i të paditurës, duke e atakuar të njëjtin për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit të aprovoj ankesën si të bazuar ndërsa aktgjykimin e atakuar ta prishë dhe lëndën t’ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim ose të ndryshoj.

Përgjigje në ankesë nuk kanë parashtruar ndërgjyqësit.

Gjykata e Apelit e Kosovës si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditëset, përmes të autorizuarit të tyre, në gjykatën e shkallës së parë, me datën 07.08.2019, ka paraqitur padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “E”, për kompensim demi, me kërkesë të precizuar si në parashtrësën e datës 30/03/2021.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse si dhe të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëseve, duke vendosur më decidivisht si në dispozitivin e të njëjtit. Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimit gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nuk ishte kontestues fakti se deri te aksidenti ka ardhur me fajin ekskluziv të të siguarit të paditurës, po ashtu nuk ishte kontestuese fakti se paditëset i janë nënshtruar shërbimeve mjekësore shëndetësore pranë institucioneve përkatëse dhe nga ekspertiza mjekësore e punuar nga eksperti Dr.E.M-ortoped-traumatolog dhe ekspertja Dr.Sh.P-H- psikiatër, është vërtetuar se paditëset, në aksidentin e datës 31.05.2019, kanë pësuar lëndime të lehta trupor si dhe frikë të përshkruara si në arsyetimin e aktgjykimit, ndërsa me ekspertizën e makinerisë është vërtetuar demi material në lartësi prej 975.00 euro. Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë i është referuar neneve 130, 140, 159, 169, 179, 183 dhe nenin 382 të LMD-së dhe neneve 449, 452 par.1 dhe 463 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pikat (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK, dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, e për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala e paditur me ankesë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk qëndron pretendimi ankimor i të paditurës për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, sepse në bazë të provave të administruara, nuk ishte kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë se deri te aksidenti i ndodhur me datën 31/05/2019 ka ardhur si rezultat i lëshimeve të siguruarit të të paditurës, e po ashtu si pasojë e këtij aksidenti e paditura nuk e ka kundërshtuar faktin se paditësja D.K ka pësuar lëndime të lehta trupore, e të cilat lëndim janë manifestuar me dhembje fizik dhe frikë, ashtu siç kanë konstatuar edhe ekspertët mjekësor në mendimin dhe konstatimin e tyre profesional ndërsa me ekspertizën e makinerisë të punuar nga eksperti A.H, vërtetohet lartësia e demit në automjetin e të paditurës D.K në shume prej 975.00 euro, dhe në këtë kuptim gjykata e shkallës së parë drejt ka vërtetuar gjendjen faktike, për faktin se me nenin 321 paragraf 1 dhe 2 të LPK-së, përcaktohet se: “ Nuk ka nevojë të provojë faktet e ditura botërisht e as faktet që i ka vërtetuar gjykata në gjykimet e më hershme, gjykata nuk ka nevojë të provoj as faktet të cilat pala i ka pohuar para gjykatës gjatë procesit gjyqësor ”, në këtë rast e paditura i ka pohuar pothuajse të gjitha faktet e theksuara më lartë. Në këtë rast e paditura në seancën e shqyrtimit kryesor edhe pse e ka kundërshtuar pjesërisht lartësinë e kërkesëpadisë e njëjta me asnjë provë bindëse nuk ka argumentuar të kundërtën e pretendimeve nga padia, edhe pse ka pasur për detyrë ta bëjë një gjë të tillë në kuptim të nenit 7 paragraf 1 dhe 319 paragraf 1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se në kuptim të dispozitave materialo-juridike të lartcekura e në përputhje me gjendjen faktike të vërtetuar në këtë procedurë, për kërkesën e aprovuar në shumën sikurse në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, gjykata është e mendimit se e njëjta është adekuate, e krejt kjo duke marr parasysh dëmin që i është shkaktuar paditëses si dhe shkallën e të mirës nga e cila është privuar dhe se lartësia e shumës së të hollave në emër të kompensimit, do t'i mundësoj të dëmtuarve- këtu paditësve, satisfaksion që ata me këto mjete t'i riparojnë në një masë nevojat e tyre materiale, këto shuma janë në harmoni edhe me praktiken gjyqësore të krijuara deri me tani si dhe me Udhëzimin e Gjykatës Supreme të Kosovës për caktimin e kritereve orientuese dhe lartësisë se shpërblimit të drejtë në të holla të demit jo material Gj.A.nr.41/2023 e dt.27/02/2023. Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar si të pabazuara pretendimet ankimore të palës ankuese lidhur me aplikimin e gabuar të së drejtës materiale sepse gjykata e shkallës së parë drejt i ka aplikuar dispozitat materiale të paraparë me nenin 130, 140, 159, 169, 179, 183, të LMD-së.

Vendimi sa i përket kamatës nga gjykata e shkallës së parë, drejtë është aplikuar e drejta materiale, lartësia e kamatës është në pajtim me nenin 382 të LMD-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, që do të ndikonte në ligjshmërinë e aktgjykimit, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
Ac.nr.6280/19, me datë 25/03/2024

Kryetar i kolegjit-Gjyqtari
Liridon Maloku